

RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR KOMUNËN E GJILANIT

Shkurt 2015

Instituti Demokratik i Kosovës - KDI / Transparency International Kosova - TIK

Ky raport financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë, si pjesë e projektit “Transparenca dhe Llogaridhënia në Prokurimin Publik në Komuna”. Ky projekt ka për qëllim që të rrisë transparencën dhe rregullsinë e proceseve të prokurimit në nivelin lokal në Kosovë, përmes fuqizimit të OJQ-ve lokale për monitorimin e procedurave të prokurimit publik.

Qëndrimet në këtë raport janë të KDI/TIK dhe jo detyrimisht korrespondojnë me qëndrimet e donatorit.



British Embassy
Pristina

Përmbajtja e Raportit

Hyrje	4
Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Gjilanit	5
Të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm	5
Kontrata për furnizim me derivate për vetura dhe gjeneratorë.....	6
Kontrata për ndërtimin e trotuarit, rregullimi I kabinave për pritje të autobusëve ne rrugën Mulla Idrizi deri te shkolla fillore ne lagjen e Zabelit	7
Kontratë për furnizimin me naftë për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Gjilanit	9
Tenderi për mirëmbajtje dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Gjilanit	10
Konkluzione	13

Hyrje

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosova (TIK), ka filluar iniciativën e monitorimit të prokurimit publik në nivel lokal, përkatësisht në 5 (pesë) komuna të Republikës së Kosovës. Kjo iniciativë ka lindur pas monitorimit të nivelit qendror, përkatësisht 4 (katër) ministrive të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Infrastrukturës (MI) dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Në këto ministri, KDI ka arritur rezultate në evidentimin e problemeve në prokurimin dhe ka avokuar në organet vendimmarrëse, për përmirësimin e shumë dobësive që kanë përcjell këtë proces. Po ashtu KDI ka bërë procedimin e një numri të konsiderueshëm të rasteve në Prokurorinë e Shtetit, ku ka pasur dyshime se shkeljet janë kryer me qëllim të qëllimshëm të buxhetit publik.

KDI-ja vazhdon të monitoroj prokurimin publik në 5 (pesë) komuna të Kosovës përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, Gjilanin dhe Mamushën. Këto 5 (shtatë) komuna, janë përzgjedhur nga KDI, duke pasur parasysh përfaqësimin politik dhe etnik. Të dhënat e mbledhura për tre lloje tenderësh (tenderët e furnizimit me naftë, mirëmbajtjen e rrugëve dhe një tender për shtrim të rrugëve me kubëza të betonit) do të krahasohen për çmimet e kontratave, në mënyrë që të merret parasysh se me çfarë vlere paguhen produktet e njëjta nga komunat e ndryshme. Gjithashtu do të krahasohen dosjet e tenderëve për të parë se çfarë specifikacione dhe kërkesa kanë komunat e ndryshme në raport me bizneset. Kjo bëhet me qëllim për të parë nëse janë sa duhet të detajuara kërkesat e komunave ose jo dhe në anën tjetër nëse bizneset rëndohen me kërkesa të panevojshme ose kërkesa të cilat ulin konkurrencën apo favorizojnë operatorë ekonomik të veçantë.

Synimi i KDI është që përmes këtyre analizave të ndihmojë komunat të marrin vlerën për parane publike të shpenzuar dhe për të evidentuar barrierat administrative për operatorët ekonomikë të cilat dobësojnë konkurrencën e drejtë. Gjithashtu KDI synon t'i informoj qytetarët lidhur me formën se si komunat e tyre kanë administruar me buxhetin e besuar dhe cilat kanë qenë kompanitë që kanë përfituar kontrata publike nga komunat.

Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Gjilanit

Komuna e Gjilanit është një ndër agjencitë buxhetore më të mëdha në nivelin lokal në Kosovë, pasi që për nga ana e buxhetit të përgjithshëm komunal radhitet si komuna e katërt. Gjilani është një komunë e cila ka një buxhet të përgjithshëm prej 20,125,842 euro. Prej këtyre mjeteve 3,806,055 euro janë të destinuar për shpenzimet kapitale, 3,497,910 euro për mallra dhe shërbime, ku në këtë rast këto dy lloje të shpenzimeve kanë një vlerë prej 7.3 milion eurove dhe të gjitha këto shpenzohen përmes prokurimit publik. Ndërsa, pjesa tjetër e mbetur shpenzohet si për paga dhe mëditje 11,635,300 euro, për subvencione 558,800 euro, për staf 2,452 euro dhe për shpenzime komunale rreth 627,777 euro.¹

Komuna për vitin 2014 pati 49 njoftime për kontratë, 79 njoftime për dhënien e kontratës dhe 11 njoftime për anulimin e kontratës, të nxjerrë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP). Këtu shihet se në 30 projekte nuk ka pasur fare njoftim për kontratë, konkurrenca për bizneset ka qenë e limituar, për arsye se vlera e këtyre tenderëve ka qenë nën vlerën minimale përkatësisht nën vlerën prej 10 000 euro. Gjithashtu njoftimet për anulimin e kontratave janë një e dhënë shqetësuese për prokurimin e komunës së Gjilanit. Numri i madh i tenderëve të cilët janë të anuluar tregon për efikasitetin e dobët të procedurave tenderuese.

Të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm

Zyra e Auditorit të përgjithshëm ka konstatuar disa probleme në Komunën e Gjilanit në prokurim publik. Kontratat janë menaxhuar dobët dhe kjo ka rezultuar me vonesa në kryerjen e punëve dhe gjithashtu në rritje të vazhdueshme të obligimeve. Gjithashtu, auditori ka analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Po ashtu ka rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara të cilat edhe realizohen gjatë vitit. Auditori ka rekomanduar që duhet gjithsesi të ketë kontrolle më të mëdha në mbikëqyrjen e projekteve.

ZAP ka gjetur se komuna ka vazhduar të kompensoj punonjësit e saj të brendshëm në cilësinë e organeve mbikëqyrëse dhe komisionet për pranim teknik pavarësisht rekomandimeve të ZAP të dhëna në vitin e kaluar për ta zgjidhur këtë çështje. Organet mbikëqyrëse janë kompensuar me 1% të shumës së përgjithshme të kontratës. Kontratat e identifikuar në vitin 2013 ishin: “Punë publike-projekte të vogla të infrastrukturës”; “Rregullimi dhe vendosja e semaforëve në qendër të qytetit” dhe “Hapja dhe rregullimi i rrugëve të rendit të tretë”.

Në dy raste menaxheri i prokurimit kishte marrë pjesë si organ mbikëqyrës i projekteve kapitale: tek kontratat “Mirëmbajtja teknike e objekteve komunale” dhe “Ndërtimi i rrugëve lokale”. Menaxheri ishte caktuar në kohën kur nuk ushtronte detyrën e menaxherit, mirëpo ka vazhduar edhe pasi është zgjedhur si menaxher i prokurimit. Edhe ky ishte kompensuar me 1%.

¹ Buxheti i Kosovës për vitin 2015, Ministria e Financave, marrë më 22 shkurt 2015

Procesi i prokurimit për “Rregullimin dhe hapjen e rrugëve të rendit të tretë në Komunën e Gjilanit” ishte përcjellë me disa parregullsi: Ofertuesi “Bejta Commerce” ishte shpallur si i pa përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues për mosplotësim të kërkesave të stafit profesional. Ky arsyetim ishte i pa qëndrueshëm sepse ofertuesi kishte ofruar dokumentin e kërkuar. Në kuadër të kërkesave teknike, ofertuesit “Bejta Commerce” dhe “Bass Com” (fituesi) kishin paraqitur një pjesë të pajisjeve (eskavator) me të njëjtat dokumente të pronësisë. Në dosje të tenderit nuk kishte ndonjë dëshmi (marrëveshje) për shfrytëzim të këtyre pajisjeve. Përveç kësaj, një sërë dokumentesh tjera të këtyre ofertuesve ishin krejtësisht të njëjta. Autoriteti kontraktues nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për t’i sqaruar këto çështje ndonëse kishte indikacione për bashkëveprim nga këta dy ofertues.

Kontrata për furnizim me derivate për vetura dhe gjeneratorë

Për dallim nga komunat tjera të cilat karburantet po paguajnë me një çmim shumë të lartë se sa çmimet që sillen në treg, komuna e Gjilanit karburantet paguan me një çmim jo normalisht të ulët. Kjo komunë ka lidhur një kontratë kornizë në muajin nëntor 2014 dhe për tri vitet e ardhshme do të paguaj për një litër naftë 0.0001 euro për premium. Kjo e dhënë është vërejtur nga KDI/TIK në kuadër të monitorimit të prokurimit publik për komunën e Gjilanit.

Nga hulumtimet tona nëpër komuna, kemi vërejtur se komuna e Gjilanit ka absolutisht çmimin më të ulët për premium. Kjo madje është diskutabile në kuptimin legal, pasi që Ligji i Prokurimit Publik, çmimet e tilla i njeh si të papranueshme apo jo normalisht të ulëta. Nëse krahasojmë Komunën e Gjilanit me një ndër komunat me të mëdha p.sh Komunën e Prizrenit e cila paguan premiumin 0.15 € npremium për litër, atëherë vërehet qartë se kjo komunë ka të lidhur një kontratë me një çmim të premiumit shumë të ulët. Premium është fitimi kryesor dhe i vetëm i kompanisë që konkurron. Ky çmim është brengosës për dy arsye: Kompania Petrol Company, e furnizon Komunën e Gjilanit me çmime shumë të lira dhe këtu mund të sakrifkohet, cilësia, sasia e karburantit apo edhe vet konkurrenca e tenderit. Dyshimi tjetër është në krahasimin e çmimeve, pasi që e njëjta kompani furnizon Komunën e Prizrenit me 0.15 euro premium për litër. Për me tepër asnjë komunë tjetër të cilën ne kemi monitoruar, nuk e ka as përafërsisht këtë çmim të premiumit.

Po ashtu ky premium është në shpërpushje me kontratën e Agjencisë Qendrore të Prokurimit Publik (AQP) pasi ajo kishte lidhur po të njëjtin muaj do të thotë në nëntor 2014, me një kontratë për furnizim me 37 autoritete kontraktuese me çmime të karburanteve të cilat janë dukshëm më të shtrenjta sesa ato të komunës së Gjilanit. AQP paguan 0.026 euro premiumin e litrit të naftës, ndërsa komuna e Gjilanit 0.0001 euro, përderisa AQP kontrakton këtë artikull për mbi 37 institucione.

Çmimi i berëzës edhe pse sigurohet nga disa prej institucioneve të Kosovës ai nuk ndahet me të gjitha autoritetet kontraktuese. Andaj, në këtë formë të vetmet të dhëna në dispozicion i kanë ato të cilat i sjellin kompanitë me të cilat kanë lidhur kontratat. Mirëpo në këtë formë, autoritetet kontraktuese janë shumë të ekspozuara ndaj rrezikut të mashtrimit nga kompanitë pasi që institucionet nuk kanë mundësi që të vërtetojnë çmimet. Një bashkëpunim mes Doganës dhe Agjencisë Qendrore të Prokurimit do t’i ndihmonte autoritetet kontraktuese që të bëjnë pagesat në bazë të dhënave zyrtare dhe jo atyre që sjellin kompanie.

Për këtë tender në Komunën e Gjilanit, ka pasur shumë pak interesim nga kompanitë të cilat shesin karburante. Vetëm dy kompani aplikuan në këtë tender. Kompanitë të cilat aplikuan ishin Petrol Company nga Prishtina dhe Sh.p.k “Compact Petrol” nga Gjilani. Kompania Petrol Company, njëkohësisht edhe kompani që fitoi tenderin, ka ofertuar me një çmim për premium prej 0.0001 euro për litër, përderisa Compact Petrol ka pasur një çmim më të shtrenjtë për Premium, 0.05 euro për litër. Të dy operatorët në raportin e vlerësimit i kanë plotësuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit dhe kanë qenë të përgjegjshme. Por dallimi është shumë i madh i çmimeve të këtyre dy tenderëve prej 0.0499 euro premium për litër, kompania Compact Petrol është më e shtrenjte, dhe kompania Petrol Company ka pasur ofertën më të lirë dhe ka fituar pasi edhe kriter për fitimin e këtij tenderi ka qenë çmimi më i lirë. Sidoqoftë është shumë e paqartë çmimi jo normalisht i ulët i ofertës së kompanisë fituese dhe vendimi i Komuns së Gjilanit që megjithatë të nënshkruaj kontratë me këtë operatorë.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), nuk e ka të rregulluar çështjen e tenderimit të karburanteve dhe në këtë formë nuk e ka asnjë standard se si institucionet e tenderojnë këtë produkt. Disa kërkojnë edhe oferta fikse, disa çmime me premium, disa të tjera çmime me premium në të cilën llogaritet edhe çmimi i transportit etj. Ne konsiderojmë se fusha e tenderimit me naftë është pak a shumë kaotike për shkak të mungesës së rregulloreve dhe bazës ligjore përkatëse, për t’u furnizuar me këtë produkt i cili në tregjet ndërkombëtare mund të ketë ulje apo ngritje në vazhdimësi. AQP përkundër përgjegjësisë ligjore nuk ka lidhur kontrate të centralizuar për produktet e naftës, e cila do të ishte më e lehtë të mbikëqyrej dhe kontrollohej çmimi dhe cilësia nga institucionet mbikëqyrëse, si dhe do të fitohej në vlerë për parane e shpenzuar.

Është shumë e nevojshme që një institucion qendror publik të siguroj çmimin e karburanteve në mesatare mujore, për arsye që në këtë mënyrë edhe buxheti i shtetit mund të kursej shumë para vetëm duke u koordinuar më mirë institucionet shtetërore dhe duke i ndarë më mirë informacionet.

Të gjeturat në këtë kontratë për karburante të cilat janë vërejtur si çështje të ndjeshme tek nafta, vlejné edhe për pjesën e furnizimit me benzinë, por pasi që me naftë shpenzohet katër fish më shumë sesa benzina, në këtë komunë, ne jemi fokusuar më shumë tek çështjet e naftës.

Kontrata për ndërtimin e trotuarit me kubëza betoni

Kontrata e dytë e analizuar nga KDI/TIK për Komunën e Gjilanit, është kontrata për ndërtimin e trotuareve, rregullimin e kabinave për pritje të autobusëve në rrugën “Mulla Idrizi” deri te shkolla fillore në lagjen e Zabelit, e lidhur me 13 tetor 2014 me një kosto të përgjithshme prej 59.509,095 euro, me një plan dinamik 60 ditore sipas kontratës për punë për kryerjen e punëve, e cila është edhe njëra prej tre llojet e tenderëve që e monitorojmë në të gjitha komunat.

Për këtë procedurë tenderuese kanë aplikuar gjithsej 10 kompani, nga të cilat 6 (gjashtë) ishin të përgjegjshme, ndërsa 4 (katër) kompani janë shpallur të pa përgjegjshme nga Komisioni për shqyrtimin e ofertave, për shkak të mungesave në dokumentacion. Kompanitë e përgjegjshme në këtë tender, janë :

Tenderi	Emri I operatorit ekonomik ofertues	Adresa	Çmimi I ofertuar ne €
1	NPN "VISION PROJECT"	Gjilan	82,106.00 €
2	COMPANY BEJTA COMERCE	Gjilan	92,062.46
3	"EL BAU" sh.p.k	Gjilan	83,656.00
4	NTP "BASS COM"	Gjilan	91,509.35
5	Sh.p.k "TEUTA-M"	Gjilan	59,590.95
6	"COMPANY ZUKA COMERCE" sh.p.k	Gjilan	

Siç vërehet edhe nga kjo tabelë më lartë, kompania fituese e këtij tenderi ishte tenderi me çmimin më të ulët, kompania TEUTA-M. Por, dallimi mes kompanisë fituese dhe kompanive tjera të cilat ofertuan për këtë tender është shumë e madhe. Shihet se dallimi me kompaninë tjetër me ofertën me te lire pas kompanisë fituese është 22,515.05 euro, ndërsa dallimi me kompaninë tjetër me ofertën me të shtrenjte në ofertat e operatoreve ofertues të përgjegjshëm ishte 32,471.51 euro. Kjo do të thotë se çmimet janë pak të ulëta.

Çmimi i kontratës për njësi është i kontraktuar me 6.5 euro për metër katrorë (m²) shtrim me kubëza betoni me trashësi prej 8 centimetër (cm). Ky është çmim shumë i ulët, krahasuar me çmimet e tregut në përgjithësi, ku çmimet për këtë artikull në mesatare janë 12 euro për m². Çmimin më të lirë që deri sot kemi hasur dhe i cili edhe ashtu është cilësuar jo normalisht i ulët ka qenë në Komunën e Prizrenit, ku kubëzat janë kontraktuar me 8 euro për m². Në anën tjetër komuna e Gjakovës ka paguar çmime shumë më të larta për këtë artikull, përkatësisht me 16 dhe 18 euro për m². Ky çmim i kontraktuar nga Komuna e Gjilanit, nuk i garanton cilësi dhe as kryerje të punimeve në afatin e paraparë me planin dinamik, sidoqoftë në këto raste i rekomandohet komunës që t'i kushtojë vëmendje të posaçme mbikëqyrjes së punimeve në cilësi dhe afat kohorë dhe në rast të problemeve të shqiptohen gjobat e parapara deri në konfiskim të sigurisë së ekzekutimit të tenderit. Për më tepër Komuna e Gjilanit aktualisht nuk ka të angazhuar kompani profesionale për mbikëqyrjen e punimeve dhe këtë i duhet ta bëjë me stafin e vet, kështu do ta ketë dyfish më të vështirë të përcjell kryerjen e suksesshme të punëve dhe monitorimin e kontratave.

Ndërkohë që edhe në këtë tender vlen të thuhet se dosja e tenderit e hartuar nga komuna, ka qenë shumë më precize sesa komunat e tjera të cilat janë monitoruar. Përmes kësaj dosje kompanive u është minimizuar mundësia e mashtrimit përmes çmimeve për njësi. Çështja e vetme që nuk ka funksionuar edhe në këtë rast është çmimi jo normalisht i ulët, të cilin zyrtarët e prokurimit dhe njësia e kërkesës në këtë rast drejtoria përkatëse, kanë mundur shumë lehtë ta dinë se ky çmim nuk u garanton se kontraktori do të bëjë punë kualitative dhe çmimet nuk janë në përputhje me tregun.

Kontratë për furnizimin me naftë për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Gjilanit

Kjo është edhe kontrata e tretë e cila është analizuar në këtë raport. Komuna e Gjilanit ka lidhur dy kontrata, për të njëjtin artikull, me të njëjtin operatorë ekonomik dhe për më tepër me të njëjtin çmim. Kontrata për furnizim me naftë për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Gjilanit u lidh me 10 tetor 2014 e cila do të distribuohet sipas porosive nga Autoriteti Kontraktues si: Drejtorati i Arsimit, QKMF-ja, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoratet e tjera shpenzuese të kësaj komune. Në këtë njoftim për kontratë kanë ofertuar tre ofertues ku të tre ofertuesit ishin të përgjegjshëm. Ofertuesit e kësaj kontrate ishin “Petrol Company” nga Prishtina, “HIB Petroil” nga Ferizaj dhe “Flamuri” nga Suhareka. Si edhe në kontratat e lartpërmendura, ashtu edhe kjo kontratë si kriter për dhënien e kësaj ishte çmimi më i ulët. Kështu që edhe fituese e kësaj kontrate ishte “Petrol Company” me një çmim të premiumit 0,0001 euro për litër, në total 1,0508 euro për litër (për muajin nëntor), për dallim nga dy kompanitë tjera që kishin një çmim të premiumit më të lartë. Sasia e përafërt është 160.000 litra me një kohë të shpërndarjes deri në fund të muajit maj 2015.

Për dallim nga kontrata për furnizim me derivate për vetura dhe gjeneratorë, sasia e së cilës ndahej në naftë dhe benzinë, edhe pse pjesa më e madhe e shpërndarjes së furnizimit ishte me naftë, këtu në këtë kontratë e gjithë sasia e shpërndarjes do të bëhet me naftë. Edhe këtu është shqetësuese çmimi i premiumit pasi që është një çmim shumë i ulët, dhe në këto raste vjen deri te dyshimi te kalkulimi jo i drejtë i çmimit, cilësia dhe sasia e dyshimtë etj.

Sikurse edhe në komunat e tjera të Kosovës, kalkulimi i çmimit është ofruar të bëhet në çmimin e berzës së PLATTS². Komuna e Gjilanit në këtë rast nuk ka të dhëna për çmimin e karburanteve në berzat ndërkombëtare, dhe për këtë ajo u bazua në të dhënat e çmimit të ofertës që sjelli edhe kompania private që fitoi tenderin. Por mbetet gjithsesi e dyshimtë metoda se si do ta vërtetoj komuna nëse këto çmime janë të vërteta, nëse nuk ka të dhëna të tjera për krahasim.

Berëza e çmimit të naftës, plus taksat e aplikueshme në Kosovë, çmimi i transportit dhe premiumi. Berëza e çmimit të naftës nga Kompania Petrol Company për të dy kontratat të fituara për furnizim me derivate dhe gjeneratorë si dhe ajo për furnizim me ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Gjilanit. Gjithashtu, kësaj berëze i vihen plus taksat e aplikueshme në Kosovë, çmimi i transportit pa premium. Premiumi i shtohet në fund te vlerës së përgjithshme që është 1.0507 euro për litër (për muajin nëntor), që do të thotë në total arrin vlerën 1.0508 euro për litër.

² PLATTS – është një burim i informacionit me parapagim për çmimet standarde të karburanteve dhe energjisë

Tabela 1. Vlerat Fikse dhe Variabile.		
Data- 30.11.2014	NENTOR / 2014	Vërejtje!
Lloji I Derivatit	EURO DIESEL	
Kursi mesatar mujor I dollarit	0.8018\$=1.2472	
Pesha specifike variabile në Kg/Litër (1,000 Kg=1,1910 L)	Litra 1.1910	25 Tx1.191L= 29,775L
Çmimi mesatar mujor I Euro Dieselit në Dollar/Ton.	\$736.76	
Akciza e Euro Dieselit për Ton.	€ 360.00/T	0.360 euro/litër
Transporti për maune nga Dogana,rruga Shqipëri-Maqedoni-Kosove	500.00 Euro	
Premiumi I rafinerise vlera shtesë nga Çmimi mesatar botëror për T	\$49.00	
Premiumi I operatorit fitues,I shprehur ne euro për litër	0.000 euro	

Tabela 2.Përlogaritja e Çmimit kushtues për euro/diesel.

Përlogaritja.	Vlerat monetare	Njësia	Statuti	Përshkrimi
A	0.73676	/kg	Variabil	Çmimi CIF i Platts-it.
B	\$ 0.0490	/kg	Fiks	Premiumi I rafinerisë mbi Platts.
C=A+B	0.78576	/kg	-	CIF Platts+Premiumi I rafinerisë.
D	1.2472	-	Variabil	Çmimi mesatr mujor I \$/€.
E=C/D	0.63002	/kg	-	Çmimi pa transport.
F=E/1.191	€ 0.5290	/liter		Çmimi për Kg I konvertuar në Lit.
G	€ 0.0168		Fiks	Transporti € 500/29,775 L.
G1	€ -		Fiks	Taksa rrugore 100€/Maune.
H=F+G+G1	€ 0.5458			Çmimi bazë pa shërbimet doganore
J	€ 0.3600	/liter	Fiks	Akciza 0.36 euro/litër.
K=H+J	€ 0.9058			Çmimi bazë për kalkulim pa TVSH
L=K*16%	0.1449		Fiks	Tvsh-ja për litër.
N=K+L	1.0507	/liter		Çmimi total pa Premium
P	0.0000	/liter	Fiks	Premiumi I operatorit për litër
O=N+P	1.0507	/liter		Çmimi kushtues

Tenderi për mirëmbajtje dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Gjilanit

Komuna e Gjilanit me datë 23.02.2015 lidhi kontratë pune me Kompaninë Zuka Comerc sh.p.k nga Gjilani, njëkohësisht edhe fituese e tenderit për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Gjilanit. Kjo kontratë do të bëjë pastrimin e borës dhe akullit. Tenderi është i ndarë në dy pjesë, në atë të mirëmbajtjes së rrugëve në qytet ku do të pastrohen të gjitha rrugët e qytetit me fshatrat dhe rruga me asfalt dhe në anën tjetër mirëmbajtja e rrugëve rurale ku do të pastrohen fshatrat dhe

lagjet rrugët me zhavorr. Çmimi për pjesën e parë është 35,111.00 euro dhe çmimi për pjesën e dytë është 23,900.00 euro. Vlera e përgjithshme e këtij tenderi është 59,011 euro. Në këtë tender janë analizuar dosja e tenderit, paramasa dhe paralogaria, kontrata e punës e kompanisë fituese dhe raporti i vlerësimit të tenderëve të cilat kanë ofertuar.

Gjatë procesit të tenderimit në këtë tender të mirëmbajtës së rrugëve dimërore në OSHP janë parashtruar dy ankesa nga operatori ekonomik EL-BAU si palë e pakënaqur.

Ankesën e parë El-Bau e kishte bërë në muajin dhjetor të vitit të kaluar kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit duke pretenduar se Komuna e Gjilanit nuk ka respektuar nenin 6, 7 dhe 27 të LPP-së gjithashtu edhe nenin 26 të Rregullores së Prokurimit Publik. Këtu ankuesi është ankuar se Komuna e Gjilanit me ndryshim dhe mos precizim të sasive në paramasë. Me të drejtë operatori është ankuar se ndryshimi i paramasave që ka bërë Komuna e Gjilanit nuk siguron që fondet publike të përdorën në mënyrë të drejtë ekonomike nuk u jep hapësirë të gjithë operatorëve ekonomik të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe favorizon operatorët ekonomik.

Po ashtu Aurotiteti Kontraktues duke lënë sasinë me vlerë 1, u hap rrugën çmimeve manipulative duke dëmtuar buxhetin. Andaj ankuesi ka kërkuar nga OSHP që të eliminohen diskriminimet dhe kriteret të cilat kufizojnë konkurrencën gjithashtu duke respektuar rregullat e prokurimit publik. Në këtë rast ankesa nga operatori ekonomik ishte në anën e tij dhe u cilësua si e bazuar dhe lënda u rikthye në ritenderim. Mbetet dilemë se pse Komuna e Gjilanit ka përcaktuar sasinë me peshë të njëjtë 1, kur dihet mirë se kjo formë e dosjes së tenderëve nuk është precize dhe oferta më e ulët nuk do të thotë se do të rezultojë e tillë edhe në implementim të kontratës. Në fakt Komuna e Gjilanit çdo herë në dosjet e tenderit ka paraparë sasinë e përafërta dhe e njëjta ka ndodhur edhe në këtë tender, ku njësia e kërkesës i ka dërguar sasinë e përafërta, mirëpo në proces kjo dosje është ndryshuar. Me këtë rast komuna e Gjilanit ka krijuar një kontest dhe vonesë të pa nevojshme në OSHP, pasi që nuk ka pasur asgjë për të përfituar nga ndryshimi i dosjes së tenderit.

Për dallim nga ankesa e parë, ankesa e dytë nga operatori ekonomik është e refuzuar. Edhe kjo ankesë ka të bëjë me disa ankesa për mosrespektimin e disa neneve të LPP-së dhe Rregullores së Prokurimit, ku sipas ankuesit thuhet se është shpërblyer me kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm i cili edhe nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike siç janë kërkuar nga dosja e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu nuk është në pajtueshmëri të plotë me specifikat teknike për kontratë pune në pajtim me ekzekutimet e punëve ashtu siç edhe i kërkon neni 28 tek LPP-it. Edhe këtu ankuesi e cekë se Komuna e Gjilanit ka shkelur dispozitat ligjore duke favorizuar dhe eliminuar konkurrencën dhe duke mos trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë. Referencat e kompanisë favorizuese Zuka Commerce kanë kontratë me Komunën të Novobërdës për shërbimet që kjo kompani i ka realizuar për periudhën e kaluar tri vjeçare për tenderin për mirëmbaje dimërore të rrugëve, ku për këtë referencë operatori ekonomik El-Bau thotë se e konsideron si të pavlefshme pasi edhe kishte bërë kërkesë për qasjen në dokumente apo të ndonjë fature në Komunën e Novobërdës dhe asnjë nga këto nuk u është dëshmuar. Por, në këtë rast ankesa u refuzua nga OSHP, pasi që sipas panelit shqyrtues të gjithë operatorët ekonomik të cilët kishin ofertuar kanë qenë të përgjegjshëm dhe operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Komuna e Novobërdës ka lëshuar një referencë konform kërkesave të dosjes dhe për atë referencë mbetet në përgjegjësinë e Komunës. Kriter për dhënie të kontratës ishte çmimi më i ulët.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve	Çmimi për njësi për Lot I	Çmimi për njësi për Lot
Furnizimi me rërë, ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja	3 euro m ³	5 euro m ³
Koha e kujdestarisë për 24 ore	20 euro ditë	35 euro ditë
Ngarkuesi	30 euro orë	5 euro orë
Graderi/Makina Niveluese	30 euro orë	50 euro orë

Edhe pse i njëjti operator Zuka Commerce fitoi tenderin në të dyja pjesët, nga kjo tabelë vërehet një dallim i madh në çmime tek pjesa për mirëmbajtje të rrugëve dimërore në zonat e qytetit dhe ajo në zonat rurale. Tek pjesa e mirëmbajtjes së rrugëve në qytet te furnizimi me rërë, ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja çmimin për njësi e ka 3 (tre) euro për m³, kurse tek pjesa e dytë e mirëmbajtjes së rrugëve në zonat rurale çmimi është 5 (pesë) euro për m³ për njësi. Këtu vërehet qartë se në pjesën e dytë është dallimi për 2 (dy) euro për m³ për njësi më i shtrenjtë. Në anën tjetër është edhe kalkulimi i çmimit të kohës mesatare të kujdestarisë për 24 orë që vlen vetëm për një (1) kamion tek pjesa e parë është 20 euro për ditë ndërsa tek pjesa e dytë koha e kujdestarisë për 24 orë e cila vlen vetëm për 1 (një) automjet paguhet me 35 euro për ditë, ku edhe këtu diferenca është për 10 euro më e lartë tek pjesa e dytë.

Gjithashtu, dallimet tjera ishin edhe tek mënyra e kalkulimit të graderit/makinës niveluese dhe ngarkuesit. Graderi/makina niveluese për njësi në pjesën e parë paguhet me 30 euro për orë, kurse te pjesa e dytë paguhet graderi/makina niveluese paguhet me çmim 5 euro për orë për njësi. Këtu ka një diferencë shumë të madhe në çmim pasi që në pjesën e parë tek rrugët në qytet paguhet me një çmim është 25 euro për orë. Gjithashtu edhe ngarkuesi paguhet në pjesën e parë të tenderit me 30 euro për orë për njësi ndërsa në pjesën e dytë për 20 euro më shtrenjtë që do të thotë 50 euro për orë për njësi.

Paramasa dhe paralogaria për Komunën e Gjilanit janë të hartuara në mënyrë shumë të mirë pasi që matja e punëve bëhet me orë apo me metër katror (m²) dhe është në përputhje me dosjen e tenderit, për dallim nga Komuna e Gjakovës që paramasat e tenderit kanë qenë në mënyrë të gabuar të hartuara gjithashtu që edhe komuna ka ndryshuar formën standarde të tenderimit, pasi që puna kompanive është matur me gjatësi dhe jo me orë pune apo me metër katror siç janë format më të zakonshme të tenderimit të mirëmbajtjes së rrugëve e cila edhe aplikohet nga Ministria e Infrastrukturës.

Konkluzione

- Komuna e Gjilanit ka lidhur dy kontrata për naftë dhe kjo përbën precedent të dëmshëm;
- Çmimi i premiumit 0.0001 euro për litër për të dy kontratat për furnizim si ajo për furnizim me derivate për gjenerator dhe derivate dhe kontrata për furnizim për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Gjilanit është jo normalisht i ulët;
- Çmimi i ulët për dy kontratat për furnizim me naftë është i ndaluar me ligjin e prokurimit, pasi që është shumë i ulët;
- Kontrata për shtrimin e trotuarit me kubëza për m² rrezikon që punët të mos kryhen në mënyrë kualitative;
- Tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve dimërore ka pasur dy ankesa në OSHP gjatë periudhës së tenderimit;
- Operatori ekonomik ZUKA Commerce ka fituar në dy pjesët e tenderit mirëpo është e pakuptimit dallimi i madh i çmimeve në lloje për punët dhe sasi të njëjta.